

Dokument

për modalitetet e funksionimit të tryezës së diskutimit dhe këshillimit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian

Ky dokument ka si qëllim përcaktimin dhe vendosjen e disa procedurave dhe modaliteteve të punës të Tryezës së Diskutimit e Këshillimit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian për një funksionim sa më të mirë të saj. Këto rregulla miratohen nga Tryeza dhe shërbejnë deri në hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian sipas parashikimit të Kreut III, pika 3, të Urdhrit të Kryeministrit Nr.113, datë 30.8.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”

Pika 1

Qëllimi i Tryezës së Diskutimit e Këshillimit

Qëllimi kryesor i tryezës është të diskutojë, të shqyrtojë dhe të ndërmarrë qëndrime dhe rekomandime drejtuar institucioneve, Sekretariatit të Integritimit Evropian e strukturave të tjera përgjegjëse në procesin e integritimit evropian, për çështjet e fushat specifike që trajtojnë. Tryeza, gjithashtu, këshillohet në lidhje me programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e asistencës së Bashkimit Evropian për Shqipërinë.

Pika 2

Thirrja e mbledhjeve të Tryezës së Diskutimit e Këshillimit

- a) Drejtuesi i grupit ndërinstitucional të punës vendos për datën, kohën e mbledhjes së Tryezës dhe rendin e ditës.
- b) Drejtuesi i grupit ndërinstitucional të punës thërret mbledhjen e Tryezës edhe kur kjo kërkohet me shkrim nga jo më pak se një e treta e anëtarëve të saj.
- c) Në këtë rast, mbledhja thirret jo më vonë se 15 ditë nga data e depozitimit të kërkesës me shkrim.

Pika 3

Njoftimi për thirrjen e mbledhjeve të Tryezës

- a) Njoftimi për mbledhjen e Tryezës i dërgohet në formë elektronike çdo anëtar të paktën 5 ditë përpara mbajtjes së saj, në adresën e depozituar prej tij.
- b) Njoftimi për thirrjen e mbledhjes përmban formën, vendin, datën dhe kohën e vendosur për mbajtjen e mbledhjes.
- c) Njoftimit i bashkëlidhet rendi i ditës dhe materialet e çështjeve që do të diskutohen në atë mbledhje, nëse ka.

- d) Anëtarët e tryezës mund të sugjerojnë tema dhe çështje të ndryshme të lidhura me Kapitullin përkatës për t'u shtuar në rendin e ditës të paktën 3 ditë përpara mbledhjes.

Pika 4

Drejtimi i mbledhjes

Drejtuesi i Grupit Ndërinstitucional të Punës drejton mbledhjen e Tryezës, drejton diskutimet dhe siguron mbarëvajtjen e procesit diskutues e këshillues. Në mbledhje mund të marrin pjesë dhe anëtarë të GNPIE, të cilët mbulojnë çështjet e trajtuara në rendin e ditës. Drejtuesi mund ta delegojë rast pas rasti drejtimin tek një përfaqësues i institucionit udhëheqës të kapitullit.

Pika 5

Vendimmarrja

Dakordësimi i qëndrimeve dhe përfundimeve të dala rast pas rasti nga Tryeza bëhet me konsensus. Në rast të mosarritjes së konsensusit për çështjen specifike bëhet votim nga të gjithë anëtarët e Tryezës me shkrim, ku miratohet varianti që merr mbështetjen e shumicës së thjeshtë.

Pika 6

Pjesëmarrja e anëtarëve në Tryezë

- e) Anëtarët të cilët marrin pjesë individualisht në Tryezë nuk mund ta delegojnë pjesëmarrjen e tyre tek individë të tjerë.
- f) Organizata e institucionet pjesëmarrëse në Tryezë duhet të njoftojnë ndryshimin e përfaqësuesit të paktën 3 ditë përpara mbajtjes së mbledhjes së Tryezës.

Pika 7

Pranimi i anëtarëve të rinj në Tryezë

Për anëtarët e rinj që synojnë t'i bashkohen tryezës, pranimi ose refuzimi i aplikimit bëhet nga drejtuesi i Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian. Refuzimi i aplikimit duhet të jetë i arsyetuar.

Pika 8

Largimi i anëtarëve nga Tryeza

Anëtarët e Tryezës të cilët nuk marrin pjesë në 3 mbledhje të njëpasnjëshëm pa arsye, humbasin të drejtën për të qenë pjesë e Tryezës.

Pika 9

Sekretariati

Struktura përgjegjëse për integrimin evropian pranë institucioneve udhëheqëse e cila vepron si Sekretariat i Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian mbështet gjithashtu teknikisht dhe administrativisht punën e Tryezave.